

Me 30/03 2018
Deni 13.04.2018



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas/Glllogoc
Udhëheqësi i Personelit
01Nr. MM-13097 dt. 30.03 /2018

Bazuar në nenin 11 dhe 12, paragrafi 1.1 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nënnet 14,15,16 të Rregullorës Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, Komuna Glllogoc/Drenas, U.D.Udhëheqëse e Personelit shpall:

KONKURS PUBLIK

Për pozitën: Zyrtar për Shërbime Sociale 2

Numri i kërkuar për pozitën; 1(një) Zyrtar për Shërbime Sociale 2

Emri i institucionit rekrutues:	Komuna Drenas/Glllogoc
Nr. i references:	1
Pozita e punës:	Zyrtar për Shërbime Sociale 2
Institucioni:	Qendra për punë Sociale
Divizioni/njësia:	
Lloji i pozitës:	I Karrierës
Tipi i akt emërimit të punës:	Orar të Plotë
Pozita e punës së mbikëqyrësit:	Drejtori
Kategoria Funksionale –Grada	Niveli Profesional, grada 9, Koeficienti 7,5
Mbulesë buxhetore si pas Ligjit të Buxhetit:	Po
Procedura e Aplikimit:	I Jashtëm
Numri i kërkuar:	1 punëtor/e
Kohëzgjatja e emërimit:	I përhershëm

Kategoritë funksionale dhe gradat e punës, vendndodhja e pozitave: Niveli Profesional, grada 9, Koeficienti 7,5 Qendra për Punë Sociale, Komuna Drenas.

Detyrat Kryesore

1. Zbatimi i Ligjit nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotsimin e ligjit nr.2003/15 për Skemen e Ndhimes Sociale ne Kosovë si dhe udhezimeve inplementuese.
2. Procesimi i Aplikacioneve
3. Procedura e verifikimit,riverifikimit ne teren.
4. Respektimi i afateve për bazen e te dhenave.
5. Sistemimi i dosjeve aktive dhe pasive.
6. Raportimi javorë te shefi i SNS
7. Pregaditja e lendeve per KM.
8. Perfshirja e dokumentave te reja dhe futja e tyre ne dosje.
9. Azhurimi i lendeve sipas afateve ligjore.
10. Kryerja edhe e punëve tjera sipas urdhërit te Drejtorit të QPS.

Kualifikimi i nevojshm arsimor, aftësitë specifike dhe përvoja paraprake e punës:

- Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik, Ekonomik, Fakulteti Filozofik-Drejtimi *Sociologji*, 2 vjet përvojë pune Profesionale.
- Njohje kompjuterike të programeve (Word,Excel,Power Point,Access),
- Aftësi komunikimi me kolegët, palët, eprorët dhe rrethin,
- Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion.

Një përshkrim i shkurtër i përzgjedhjes si dhe një përshkrim i Rregullorës ekzistuese e cila rregullon çështjen e rekrutimit:

Përzgjedhja bëhet në bazë të listës së ngushtë e cila hartohet pas rezultateve të testit me shkrim dhe pas intervistës me gojë në bazë të Rregullorës për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, nr. 02/2010.

Kohëzgjatja e emërimit : I karrierës.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, nga dita e publikimit **30/03/2018** deri më **13/04/2018**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12,gjatë orarit të punës,Qendra për Shërbimin e Qytetarëve.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Aplikacionit i bashkangjiten kopjet dokumentacionit për kualifikim arsimor të noterizuar dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme për këto vende pune,për të cilat konkurohet.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, të mangëtat refuzohen.Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër (ngushtë) njoftohen përmes faqesë së komunës dhe shalljes në hyrje të komunës.



E.D. Udhëheqëse e Personelit

Hamumshahe Shabani